

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22, dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010 dhe Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 nr. 350/02-21010/21 dt.02.02.2021, të pronarit Musaj Gashi nga Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin ndërtesës individuale banimore / shtëpisë familjare, në kuadër të Planit Rregullues Ndryshim dhe Plotësimi “Arbëria 3”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 25.02.2021, merr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I Caktohen kushtet ndërtimore pronarit Musaj Gashi, nga Prishtinë, sipas kërkesës 05 nr. 350/02-21010/21 dt.02.02.2021, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e ndërtesës individuale banimore / shtëpisë familjare, me etazhitet P+1, në kuadër të Planit Rregullues Ndryshim dhe Plotësimi “Arbëria 3”, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10362-0, ZK. Prishtinë.

II. Lokacioni / parcela kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të Planit Rregullues Ndryshim dhe Plotësimi “Arbëria 3”, i miratuar sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës 01 nr. 035-94056 dt. 04.05.2015, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim: A1- i ulët –sipas ekstraktit.

Për parametrat, kriteret urbane dhe kushtet e ndërtimit, kërkuesi është informuar përmes "Informim nga Planit Rregullues Ndryshim dhe Plotësimi “Arbëria 3”, me referencë nr. 04-350/01-152152/20 dt.27.08.2020, të lëshuar me dt. 03.09.2020, lëshuar përmes Qendrës për shërbim me qytetarë nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm të Komunës së Prishtinës.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, bashkëpronarët dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
 - Nr. 10362-0, ZK. Prishtinë, S=939m², Musaj Gashi..”Arë e klasës 5”;
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale të lartcekur, bazuar edhe në incizimin gjeodezik, gjendet një shtëpi P+1, dhe një garazhë e cila do të rrënohet;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni është relativishtë i rrafshët;
- Qasja në parcelë kadastrale nr.10362-0, ZK. Prishtina, bëhet përmes rrugë ekzistuese “Gjergj Balsha”;

- Në kuadër të perimetrit prej 50m' të parcelës kadastrale në fjalë, përfshihen ndërtesa individuale banimore.

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin – ndërtimin e ndërtesës individuale banimore / shtëpisë familjare, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, bazuar në parametrat urban të planit, janë:

- Organizimi dhe qasja në parcelë, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelës, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Plani i lokacionit – “Situacioni i ngushtë”, bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Destinimi i shfrytëzimit, sipas Plani Rregullues Ndryshimi dhe Plotsimi “Arbëria 3”, është A1-Zona e banimit të ultë, ndërtesës individuale banimore / shtëpisë familjare, të jetë për banim familjar dhe me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo dhe hapësira garazhesh etj. (sipas projekt propozimit);
- Pjesa e parcelës kadastrale brenda vijës rregulluese, e trajtuar me këto kushte ndërtimore, është:
 - 10362-0, S=351.30m².
- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10362-0, ZK. Prishtinë, planifkohet ndërtimi i ndërtesës individuale banimore / shtëpisë familjare, me sipërfaqe ndërtimore, shtrirje dhe etazhitet, sipas llogarive dhe projektit konceptual, si në vijim:
 - S=208.12 m²/e gjitha mbi tokë /
 - Etazhitet: P+1
- Etazhiteti i ndërtesës individuale banimore / shtëpisë familjare, sipas Planit Rregullues Ndryshim dhe Plotësimi “Arbëria 3” është max. I ÷ II etazhe, e propozuar dhe e miratuar P+1;
- Indeksi i shfrytëzimit të parcelës (ISHP), sipas Planit Rregullues Ndryshim dhe Plotësimi “Arbëria 3” është max. 0.3 (30%) e sipërfaqes së parcelës.
Ndërtesë individuale banimore / shtëpi familjare:
S=351.3 x 0.3=105.39m² / lejuar sipas Planit Rregullues Ndryshim dhe Plotësimi “Arbëria 3”/, S=104.06m²; / sipas projekt propozimit /.
- Indeksi i shfrytëzimit të nëntokës (ISHPN), është max. 0.60, bazuar në paragrafin II. Pika 1. Të Vendimit 01nr.031 – 185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës.
Ndërtesë individuale banimore / shtëpi familjare:
- Indeksi i sipërfaqes së gjelbërimit (ISGJ), sipërfaqja e gjelbëruar e parcelës, e përcaktuar në bazë të Indeksit të Sipërfaqes së Gjelbëruar, duhet të jetë së paku 50%;
Ndërtesë individuale banimore / shtëpi familjare:
S=351.3 x 0.5=175.65m².
- Qasja në parcelë kadastrale nr. 10362-0, ZK. Prishtinë, bëhet përmes rrugë ekzistuese “Gjergj Balsha”;
- Bazuar në kriteret e Planit Rregullues Ndryshim dhe Plotësimi “Arbëria 3”, distanca minimale në mes dy ndërtesave është 0.75H (aty ku ka hapje të kthinave primare), kurse distanca minimale nga kufiri i parcelës kadastrale fqinje është 0.25H. Te fasadat anësore, ku ka kthina sekondare, si: banjo, ëc, depo, shkallë dhe garazhe, me marrëveshje të fqinjëve, kjo distancë mund të jetë 0;
- Bazuar në nenin III. Të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2015 dhe protokoluuar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e “termoizolimit”, nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Për shtëpitë individuale të banimit, duhet të sigurohet 1 vendparkim, për një njësi banimi; Parkimi i jashtëm mund të planifkohet brenda vijës rregulluese duke mos e tejkaluar kushtin prej 50% për gjelbërim;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të eficiencës së energjisë, dhe ti përshtatet destinimit të ndërtesave të planifikuara;

- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore.

V. **Ndarja/parcelimi** i parcelës kadastrale 10362-0 ZK. Prishtinë, do të realizohet sipas parcelave ndërtimore, të përcaktuar me planin rregullues “Arbëria 3” dhe sipas propozimit të kërkuarit dhe miratimit nga kjo Drejtori, bazuar në Planin e situacionit - “zgjidhja urbane” dhe manualin e ndarjes të punuar nga gjeodeti i licencuar, bashkëngjitur këtij Vendimi. Andaj kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelës kadastrale të lartcekur, sipas Planit të situacionit – “zgjidhja urbane” dhe manualit të ndarjes i cili është në harmoni me planin e riparcelimit sipas Planit Rregullues Ndryshim dhe Plotsim “Arbëria 3”. Procedura e ndarjes/parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastrale, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes së parcelës të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarit, duke u bazuar edhe në Plani i situacionit – “zgjidhja urbane” dhe manualin e ndarjes së parcelës, punuar nga gjeodeti i licencuar, i cili është pjesë përbërëse e këtij Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VI. **Kyçja në infrastrukturë** – marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR ‘Prishtina’, bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga “Termokos”-Ngrohitorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VII. **Dokumentacioni ndërtimor** – projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m`, me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhësë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhësë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tridimensionale – perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të “Organizimi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim”;

Faqe 3 prej 6

- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme;

VIII. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me bashkëpronarët/investitorët. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuesit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit);

IX. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore – meqenëse parcela kadastrale nr. 10362-0, ZK. Prishtinë në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, është evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit “Arë e klasës 5”, kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Plani i situacionit – “Situacioni i ngjushhtë”, dhe parcelës ndërtimore të caktuar me Planin Zhvillimor Urban, e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore në sipërfaqe prej $S=351.3 \text{ m}^2$. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Ky kompensim – pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, pas realizimit të pikës V të këtij Vendimi, si dhe para aplikimit për leje ndërtimore.

X. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XI. Vlefshmëria e vendimit të kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

Ar sy e t i m

Pronari Musaj Gashi, nga Prishtinë, me kërkesën 05 nr. 350/02 – 21010/21 dt. 02.02.2021, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore. Me kërkesë, pronarja ka prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelat kadastrale nr. 10362-0, ZK.Prishtinë, evidentuar në çertifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-10362-0.
- Kopja e letërnjoftit.
- Vërtetimin mbi obligimet tatimore, në emër të Musaj Gashi, nr. 18370/21 dt. 29.01.2021, të lëshuar nga Drejtoria e Financave;
- Informatën nga “Planit Rregullues Ndryshim dhe Plotësimi “Arbëria 3”- së, me nr.ref. 04-350/01-152152/20 dt. 27.08.2020, të lëshuar përmes sistemit online nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës.
- Akti noterial “Pëlqim”, pronari i parcelës nr. 06170-2, ZK Prishtinë, Gani Begolli, dhënë Musaj Gashit, pëlqimin për lejimin që të ndërtoji në distancë prej 1.2m nga kufiri i parcelave të tij, i përpiluar te notere Sevdije S.Krasniqi, në Prishtinë, LRP.Nr. 1808/2021, dt. 16.02.2021;
- Incizimi gjeodezik për parcelat kadastrale nr.10362-0, ZK.Prishtinë, i punuar nga gjeodeti i licencuar Festim Islami me nr. të licensës 12.
- Foto të terrenit të lokacionit.
- Propozim ndarje e riparcelizimit i punuar nga gjeodeti i licensuar Festim Islami me nr. të licensës 12.
- Projektin ideor për parcelat kadastrale në fjalë, të punuar nga kompania Artings Project sh.p.k, me nr. të çertifikatës së regjistrimit të biznesit 810849846.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës në fjalë, si dhe dokumentacionit të prezentuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapsirën ku gjendet lokacioni, Planit Rregullues Ndryshim dhe Plotësimi “Arbëria 3”, rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, dhe projektit konceptual, ka konstatuar se parcelat kadastrale nr. 10362-0 ZK.Prishtinë, shtrihet në kuadër të Planit Rregullues Ndryshim dhe Plotësimi “Arbëria 3”, i miratuar Vendimin e Komunës së Prishtinës 01 nr. 35-94056 dt. 04.05.2015, në zonë të përcaktuar si A1- Zona e banimit të ultë.

Ky organ pas shqyrtimit të kërkesës 05 nr. 350/02 – 21010/21 dt. 02.02.2021, bazuar në nenin 13, pika 1.2 të UA të MMPH-së nr. 06/2017 dt 23.05.2017, ka vendosur njoftimin me datë 12.02.2021. Ky njoftim publik, sipas rregullativës ligjore, ka qëndruar pasë (5) ditë në fjalë, pra deri më dt.16.02.2021 dhe meqë ndërkohë kjo Drejtori nuk ka pranuar ndonjë vërejtje apo sugjerim, është vazhduar me procedurën për caktimin e kushteve ndërtimore.

Bazuar në konstatimet e më sipërme, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L- 110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 13 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve”, Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuesi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti konceptual i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të Planit Rregullues Ndryshim dhe Plotësimi “Arbëria 3”, për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore sipas këtij Vendimi. Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacionit –“Situacioni i ngushtë”, si dhe manuali për ndarje të parcelës kadastrale i punuar nga gjeodeti i licencuar.


Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA-ja.

Ky Vendim është përpiluar në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesve; në dosje të lëndës 05 nr. 350/02-21010/21 dt. 02.02.2021; kësaj Drejtorie; si dhe Qendrës për Shërbim me Qytetarë.

Përmes postës elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Kadastrit; Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 350/02-21010 DT. 25.02.2021**

Zyrtare,
Xheneta Selmani Dervishi



u.d. Udhëheqëse e Sektorit
Mimoza Berisha Prestreshi




Drejtori,
Ardian Qlluri






Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN KOORDINATIV KOSOVAREF01



Punoi:
Kushtrim Domaneku

Nënshkrimi: _____

Prishtinë: 17.03.2021

Legjenda:

----- Riparcelimi sipas PRRU
————— Parcela kadastrale



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government


Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit/Ministrastvo Infrastrukture i Sredine/Ministry of Infrastructure and Environment
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: PRISHTINË Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice: 10362-0

Zona kadastrale / Katastarska zona: PRISHTINË Numri i lëndës / Broj predmeta: _____

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: Parcelë Shkalla e zvogimit / Razmera plana: 1: 500

Nr.	Y	X	H
1	7512088.660	4724678.840	0
2	7512089.330	4724678.920	0
3	7512091.770	4724711.270	0
4	7512091.800	4724711.680	0
5	7512095.750	4724711.390	0
6	7512095.720	4724710.850	0
7	7512094.550	4724691.210	0
8	7512093.480	4724678.750	0
9	7512102.786	4724678.820	0
10	7512117.260	4724678.910	0
11	7512117.750	4724669.180	0
12	7512114.530	4724669.050	0
13	7512115.624	4724651.895	0
14	7512103.480	4724651.044	0
15	7512093.515	4724650.346	0
16	7512087.230	4724649.530	0
17	7512087.770	4724665.070	0
18	7512088.366	4724674.285	0
19	7512102.894	4724674.485	0



SHPJEGUESI


- Parcela kadastrale e propozuar
- Parcelat kadastrale
- Vija rregullative

Rr. Text

Rilevoi / Snimio: Festim ISLAMI
(emri dhe mbiemri i geodetit/kompanisë/ime i prezime geodeta/kompanisë)

Aprovoi / Usvajio: _____
(emri dhe mbiemri i përsosnit zyrtar/ime i prezime sluzbenog lica)

Nr. i licencës / Br. licence: _____
Nënshkrimi / Potpis:



Nënshkrimi / Potpis: _____
Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____

Data e rilevimit / Datum snimanja: 02.03.2021



LEGIENDA

GIENDJA KADASTRALE	DRUNJET
GIENDJA FAKTIKE	HYRJET
TROTUARI	PUSETE
RRUGA	HIDRANT
FASADA E PESTE	SHTYLL ELEKTRIKE
OBJEKTET PERRETH	SHTIGJE
BALLKON KONZOLLA	KONS. PERCIJELLES
GABARITI I PERDHESES	RRETHOJE
PIKE GJEODEZIKE	VIJA NDERTIMORE
MBETURINAT	VIJA RREGULLLUESE

SHTËPI INDIVIDUALE P+1

rr. Gjergj Balsha, Arbëri

10362-0 Prishtinë

SITUACIONI 1:200

FAZA 1

PROJEKTI KONCEPTUAL

ARKITEKTURA



KLIENTI:
Musaj GASHI
rr "Gjergj Balsha",
Arbëri, Prishtinë
Kosove
10000

Arktekte:
Qendresa Osmanaj
ARTS ININGS
PRISHTINE
Qendresa Osmanaj

JANAR, 2021

PROJEKTI ESHTË PËRME E KOMPANISË "ARTS ININGS PROJECT" SH.P. E DHE INDIKOHET ME LOGO KOO RACIONALIT PROJEKTI PA TE DREJTEN AUTORITARE	FORMATI A3	NUMRI I FLETES 12
---	---------------	----------------------

